



## NJOFTIM PËR PROKURIM

Prokurimi i Masave të Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Publike në nivel komunal në Kosovë

Data e mbylljes: 05 mars 2025 në orën 12:00 sipas Kohës Qendrore Evropiane (UTC +1)

## Faza e parakualifikimit

Shteti:	Republika e Kosovës
BMZ Nr.	200765941
Nr. i prokurimit i KfW	512302
Nr. i Ref. i ME-së	26880
Referenca:	Parakualifikim i Hapur për Punime në kuadër të Projektit “Masat e Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Publike në nivel komunal në Kosovë” për zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Publike në nivel komunal në Kosovë.
Autoriteti Kontraktues:	Ministria e Ekonomisë

1. Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Ekonomisë ka siguruar financimin nga KfW për projektin “Masat e Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Publike në nivel komunal në Kosovë” dhe synon të përdorë një pjesë të fondeve për pagesat sipas kontratës/kontratave për punimet e zbatimit të Masave të Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Publike në nivel komunal në Kosovë.

2. Ministria e Ekonomisë, në emër të Komunave përkatëse, fton tani Shprehjen e Interesit nga Ofertuesit e pranueshëm për masat e investimeve si më poshtë:

**Loti 4: Komuna e Gjakovës**

- Shkolla “Hysni Zajmi” – Gjakovë (3300 m<sup>2</sup>)
- Shkolla “7 Shtatori” – Gërçin, Gjakovë (1180 m<sup>2</sup>)

Koha e zbatimit është nëntë (9) muaj.

3. Ofertimi do të zhvillohet përmes procedurës së Ofertimit Konkurrues Ndërkombëtar sipas “FIDIC Pink Book” (dy faza, dy zarfe), siç përcaktohet në “Udhëzimet e KfW-së për Prokurimin e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve të ndërlidhura në Bashkëpunim Financiar me Vendet Partnere, versioni i dokumentit: Janar 2019, 1. I përditësuar në janar 2021. (<https://www.kfw-entwicklungsbank.de/PDF/Download-Center/PDF-Dokumente-Richtlinien/FZ-Vergaberichtlinien-V-2021-EN.pdf>).

4. Numri maksimal i kompanive në një Ndërmarrje e Përbashkët është 3 (tre), dhe Kriteret përgjithshme të Kualifikimit përfshijnë:

- Pranueshmërinë
- Mospërbushja e Kontratave në të kaluarën
- Gjendja dhe performanca financiare
- Përvoja në fushën e ndërtimit
- Përvoja dhe kapaciteti Mjedisor, Social dhe i Shëndetit e Sigurisë (ESHS)

5. Një set i plotë i Dokumenteve të Tenderit në gjuhën angleze mund të shkarkohet pas regjistrimit të ofertuesit në faqen e internetit: <https://me.rks-gov.net/shpallje-2/>

6. Për qëllime sqarimi, adresa e Punëdhënësit është:

Ministria e Ekonomisë

Për vëmendje të: Dukagjin Bakija,

Udhëheqës i Njesisë për Implementimin e Projekteve

Rr. Nënë Tereza, Nr. 36

10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Email: [dukagjin.bakija@rks-gov.net](mailto:dukagjin.bakija@rks-gov.net)

Dhe adresa e Agjentit të Tenderit është:

GOPA Infra

Për vëmendje të: Rainer Riha

Adresa: Hindenburgring 18

61348 Bad Homburg

Gjermani

Email: [rainer.riha@gopa-infra.de](mailto:rainer.riha@gopa-infra.de)

Agjenti i Tenderit do të përgjigjet me shkrim për çdo kërkesë për sqarim, me kusht që një kërkesë e tillë të jetë pranuar jo më vonë se 15 ditë para dorëzimit të aplikimit, në orën 15:00 (CET).

Qëllimi i kërkesës për sqarim dhe përgjigjet do të bëhen, mundësisht, me anë të postës elektronike.

7. Aplikuesi duhet të bashkëngjitë origjinalin dhe kopjet e Aplikimit në një zarf të mbyllur, i cili duhet:

- (a) të përmbajë emrin dhe adresën e Aplikuesit;
- (b) t'i drejtohet Punëdhënësit; dhe
- (c) të përmbajë identifikimin specifik të këtij procesi të parakualifikimit të theksuar në FDHP 1.1.

Aplikuesit mund t'i dorëzojnë Aplikimet e tyre me postë ose me fizikisht. Aplikimet duhet të dorëzohen në përputhje me udhëzimet.

8. Dorëzimi duhet të bëhen në një (1) origjinal dhe tre (3) kopje fizike, si dhe një kopje të skanuar elektronike në format PDF në një USB.

9. Aplikimi origjinal (duke përfshirë të gjitha kopjet e kërkuara) duhet të dorëzohet jo më vonë se:

- Data: 05 mars 2025
- Koha: 12:00 (CET)

në adresën më poshtë, e cila do të jetë adresa vendimtare për qëllime të dorëzimit në kohë të Aplikimit:

Ministria e Ekonomisë

Për vëmendje të: Dukagjin Bakija,

Udhëheqës i Njesisë për Implementin e Projekteve

Rr. Nënë Tereza, Nr. 36

10 000 Prishtina, Republic of Kosovo

Email: [dukagjin.bakija@rks-gov.net](mailto:dukagjin.bakija@rks-gov.net)

Një (1) kopje digjitale (CD ose USB) e Aplikimit duhet të dorëzohet jo më vonë se:

- Data: 05 mars 2025
- Koha: 12:00 (CET)

në këtë adresë:

GOPA Infra

Hindenburgring 18

61348 Bad Homburg

Gjermani

E-Mail: [rainer.riha@gopa-infra.de](mailto:rainer.riha@gopa-infra.de)

Dorëzimi në kohë i versionit origjinal të printuar në Ministrinë e Ekonomisë është vendimtar për dorëzimin me kohë.

Aplikimet e pranuar me vonesë do të refuzohen.

10. Ministria e Ekonomisë nuk ka asnjë detyrim të pranojë asnjë Aplikues që shpreh interes. Në rast se procesi i prokurimit anulohet, kompanitë pjesëmarrëse nuk kanë asnjë të drejtë kompensimi, dhe nuk do të jepen arsye për anulimin.

11. Hapja e aplikimeve do të bëhet më:

- Data: 06 mars 2025
- Koha: 12:00 (CET)

Ministria e Ekonomisë

Rr. Nënë Tereza, Nr. 36

10 000 Prishtina, Republic of Kosovo

12. Nuk kërkohet një numër minimal i aplikimeve për të vazhduar me hapjen e aplikimeve.